

Çfarë duhet të dinë prindërit rreth përmbajtjes së video-lojërave dhe zgjedhjes së duhur për fëmijët?

Misioni kryesor i ESRB (*Entertainment Software Rating Board*) është vlerësimi i përmbajtjes dhe përcaktimi i grupmoshave për video-lojërat dhe aplikacionet, për t'u dhënë prindërve mundësinë të zgjedhin ato më të përshtatshme për fëmijët e tyre. Me kalimin e kohës, nevojat dhe sfidat e prindërve kanë evoluar, prandaj çdo vit ESRB kryen anketa të rregullta për të kuptuar më mirë perceptimet e prindërve dhe për të përmirësuar mbështetjen që ofrojnë në këtë drejtim.

Sondazhi i fundit i vitit 2023, i kryer nga *Hart Research Associates*, na ofroi një pasqyrë të qëndrueshme në krahasim me vitet e mëparshme, duke treguar stabilitet në disa aspekte kyçe.

Lexo poashtu: <https://prinderimi.com/vendosja-e-kufijve-perreth-lojerave/>

Ndërgjegjësimi për sistemin e vlerësimeve të ESRB mbetet i lartë

Prindërit vazhdojnë të raportojnë një ndërgjegjësim të lartë dhe përdorim të vazhdueshëm të vlerësimeve të ESRB kur bëhet fjalë për zgjedhjen e video-lojërave për fëmijët e tyre. Në vitin 2023, 84% e prindërve me fëmijë që luajnë video-lojëra u shprehën se janë të vetëdijshëm për sistemin e vlerësimit të ESRB-së, ndërsa 73% e tyre deklaruan se e përdorin atë rregullisht për të marrë vendime të informuara. Këto të dhëna janë pothuajse të njëjta me ato të vitit të kaluar, duke reflektuar një angazhim të qëndrueshëm të prindërve ndaj këtij sistemi.

Gjithashtu, një shumicë dërrmuese e prindërve theksojnë se çdo komponent i sistemit të vlerësimit është "jashtëzakonisht" ose "shumë" i rëndësishëm për t'i ndihmuar ata të vendosin se cilat lojëra janë të përshtatshme për fëmijët e tyre.

Lexo poashtu: <https://prinderimi.com/cfare-duhet-te-dine-prinderit-per-platfomen-twitch/>


Përmbajtja e lojërave video mbetet një prioritet për prindërit

Në vitin 2023, prindërit raportuan një fokus të shtuar në gjetjen e përmbajtjes së përshtatshme të lojërave video për fëmijët e tyre. Shumica e tyre përdorin disa metoda për të bërë zgjedhjen e duhur, duke përfshirë:

- Luajtjen vetë të lojës (66%)
- Kontrollimin e vlerësimit (65%)
- Verifikimin e zhanrit (64%)
- Kërkimin online (63%)
- Bisedat me prindër të tjerë (60%).

Këto të dhëna tregojnë se përmbajtja e video-lojërave është një shqetësim konstant për prindërit, dhe zbatimi i vlerësimeve të ESRB-së mbetet një element thelbësor në këtë proces. Megjithatë, menaxhimi i kohës që fëmijët kalojnë duke luajtur është konsideruar si sfida më e madhe, dhe shumë prindër përdorin kontrolle prindërore për të përballuar këtë sfidë.

Lexo poashtu: <https://prinderimi.com/cfare-duhet-te-dine-prinderit-per-lojen-fortnite/>



Përdorimi i kontrolleve prindërore në rritje

Kontrollet prindërore janë mjete kyçe që prindërit përdorin për të menaxhuar përvojat e lojërave video të fëmijëve të tyre. Ankesa tregon se 86% e prindërve përdorin të paktën një cilësim të kontrollit prindëror në pajisjet e lojërave (një rritje nga 80% në vitin 2022). Ndër cilësimet më të përdorura janë vendosja e kufijve kohorë, menaxhimi i shpenzimeve, bllokimi i lojërave bazuar në

vlerësimet e moshës, dhe kufizimi i komunikimeve online. Këto mjete ndihmojnë prindërit të mbajnë përvojat e lojërave të fëmijëve të tyre të sigurta dhe të përshtatshme.

ESRB ofron një udhëzues hap pas hapi për aktivizimin e kontrolleve prindërore në faqen ParentalTools.org, duke e bërë më të lehtë për prindërit të vendosin masa mbrojtëse për fëmijët e tyre dhe të ruajnë paqen mendore gjatë lojës.



Prindërimi

ÇFARË DUHET TË DINË PRINDËRIT RRETH PËRMBAJTJES SË VIDEO-LOJËRAVE DHE ZGJEDHJES SË DUHUR PËR FËMIJËT?

VIDEO-LOJËRAT

Një shumicë dërrmuese e prindërve theksojnë se çdo komponent i sistemit të vlerësimit është "jashtëzakonisht" ose "shumë" i rëndësishëm për t'i ndihmuar ata të vendosin se cilat lojëra janë të përshtatshme për fëmijët e tyre.

www.prinderimi.com

VIDEO-LOJËRAT

Autore: Patricia E. Vance, Presidente e ESRB

Përktheu dhe përshtati: Perparim Blakaj

© Prinderimi.com Të gjitha të drejtat e rezervuara.